



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr. 29, datë 1/12/2023

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE “PËR PËRDORIM TË
BURIMIT UJOR SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM
HIDROENERGJETIK”, SHOQËRISË “NORD ENERGY” SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Mat,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje “Për përdorim të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik”, shoqërisë “NORD ENERGY” sh.p.k., me vendndodhje, në pellgun ujëmbledhës të përroit të Zallit të Madh, dega kryesore e përroit të Lusës, HEC “Mallunxa”, në Bashkinë Mat, Qarku Dibër, sipas këtyre koordinatave:

Treguesit paraprak janë si më poshtë:

HEC “MALLUNXA”

Vepra e marrjes:

- X= 507866.48

- $Y=4609030.92$
- $Z=340$ m.m.n.d
- $Q_{mes}=2.04$ m³/s
- $Q_{llog}=2.6$ m³/s
- $Q_{eko}=0.23$ m³/s

Godina e Centralit:

- $X=505950.27$
- $Y=4606761.72$
- $Z=252$ m.m.n.d
- Fuqia e instaluar $N=1,640$ kW
- Energjia Vjetore $E=6,780,000$ kWh/vit.

2. Zbatimi i lejes për përdorim burimi ujor nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
3. Subjekti të instaloj stacionin hidrologjik te vepra e marrjes dhe stacionin meteorologjik te godina e centralit si dhe të dërgoj periodikisht te AMBU të dhëna, referuar VKM nr.1122 e datës 30.12.2020 për “Miratimin e kërkesave, kushteve, procedurave, fondeve të nevojshme buxhetore për krijimin, mbajtjen, menaxhimin dhe përditësimin e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore”.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBUMAT

GJERGJ PRENDI

